

PLANI I PERDORIMIT TE FREKUENCAVE

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Plani i perdorimit te frekuencave hartohet per te siguruar nje perdorim efektiv dhe pa interferenca te frekuencave.

Neni 2

Objekti

(1) Plani i perdorimit te frekuencave përfshin:

- a) brezat e frekuencave të percaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr 479, dt. 06.05.2009 , për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të percaktuara në këto breza frekuencash;
 - b) rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet (të cilat më poshtë do të përcaktohen si radio sisteme) dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e operimit lidhur me operimin e radio sistemeve;
- (2) Përdorimet radio në shërbimin e lëvizshëm aeronautik ose detar dhe të lëvizshëm satelitor si dhe shërbimin e radionavigacionit dhe radionavigacionit satelitor, që përdorin frekuencat që u janë caktuar nga PKF dhe kryejnë komunikime ndërkombëtare, duhet të zbatojnë konditat e percaktuara në nenin 7.
- (3) Ky plan nuk parashikon metodën e dhënies së frekuencave në shërbimin e radiodifuzionit.

Neni 3

Baza ligjore

Në zbatim të Nenit 8 pika ë), pika p), nenit 62 pika 2 dhe germa a) të pikës 3 të, nenit 64 pika 2 e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (më poshtë ligji nr.9918)

Dispozita te vecanta

Neni 4

(1) Kërkesat e administrimit të frekuencave që sigurojnë operimin e harmonizuar të radio sistemeve janë:

- a) gjërësia e kanalit,
- b) rregulli i ndarjes së kanaleve,
- c) brezi i sigurisë,
- d) klasa e transmetimit,
- e) menyra e modulimit,
- f) menyra e komunikimit,
- g) cikli i punës,
- h) fuqia ne dalje e transmetuesit,
- i) mënyra e aksesit,
- j) polarizimi i sinjalit të emetuar dhe vlerat kufi të parametrave të tij,
- k) niveli minimal i intensitetit të fushës ose sinjali minimal i nevojshëm për marrje,
- l) kriteri i interferencës.

(2) Parametrat e administrimit te frekuencave ndaj radio pajisjeve, që nevojiten për plotësimin e kërkesave thelbësore që përmbajnë pika 1 dhe germa b) e pikës 2 të nenit 71 te ligjit nr 9918 janë si më poshtë:

- a) *parametrat e transmetuesit*: gabimi i frekuencës, stabiliteti i frekuencës, fuqia e transmetuesit, fuqia e kanalit fqinj, emetimet parazitare, shuarja e intermodulimit, koha e lëshimit, sjellja tranzitore e transmetuesit, saktësia e modulimit, cikli i punës;
- b) *parametrat e marrësit*: ndjeshmëria maksimale e përdorshme, rezhektimi ko-kanal, selektiviteti ndaj kanalit fqinj, rezhektimi ndaj emetimeve parazitare, rezhektimi ndaj intermodulimit, bllokimi, emetimi parazitare, ndjeshmëria ndaj sinjaleve nga rrugë të ndryshme;
- c) *parametrat e antenave*: përforcimi i antenës, saktësia e drejtimit të antenës, diskriminimi i polarizimit të kryqëzuar, karakteristikat e antenës, emetimi parazitare i antenave aktive.

Neni 5

Anekset dhe Nderfaqet radio bashkëngjitur janë pjesë e PPF.

Anekset përmbajnë:

- ndarjet e detajuara ne kanale të brezave të frekuencave për radio sistemet,
- kriteret për përdorimin e tyre,
- statusi i seciles frekuence,
- zona e përdorimit.

Kërkesat Teknike te Nderfaqeve radio përcaktojnë kushtet për përdorimin e frekuencave dhe pajisjeve radio për komunikimet elektronike ne breza te ndryshem frekuencash.

Neni 6

- (1) Nëqoftëse rregullat lidhur me përdorimin e brezave respektivë të frekuencave nuk parashikojnë ndryshe:
 - a) kërkesat për frekuenca do të plotësohen bazuar në principin "kush vjen i pari shërbehet i pari" nëpërmjet procedurës së autorizimit individual;
 - b) stacionet radio vetëm marrës, me përjashtim të stacioneve në shërbimet fiks dhe të lëvizshëm, do të përjashtohen nga detyrimi i autorizimit individual.

- (2) Nëqoftëse një rubrikë, në pjesën e kolonës të PPF me titull "Rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave", referuar një aplikimi radio të dhënë është e paplotesuar (bosh), atëhere nuk është percaktuar asnjë kërkesë tjetër përveç dispozitave të pika (1) të mësipërm, karakteristikave teknike të specifikuara nga prodhuesi ose personi përgjegjës për futjen në treg si dhe rregulloret përkatëse të percaktuara në Radio Rregulloren e ITU ose nga organizata profesionale ndërkombëtare që pranohen nga AKEP.

- (3) Futja në treg e pajisjeve radio duhet bere në përputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi.

Neni 7

- (1) Pajisjet radio që përdoren në bordin e avioneve dhe stacionet bregdetare të shërbimit të lëvizshëm detar dhe shërbimin e lëvizshëm detar me satelit, në rastin e përdorimit të tyre jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë disa kërkesa thelbësore.

- (2) Licensat radio të lëshuara për radio stacionet e shërbimeve të lëvizshëm aeronautik ose detar dhe të lëvizshëm satelitor, si dhe shërbimeve të radionavigimit dhe radionavigimit satelitor që kryejnë komunikime ndërkombëtare duhet të plotësojnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë pranuar nga Shqipëria.

Dispozita shpjeguese

Neni 8

- (1) Për qëllim të këtij PPF do të përdoren përcaktimet e mëposhtme:
 - a) *EIRP Mesatare*: EIRP më e lartë gjatë transmetimit, kur përdoret kontroll i fuqisë së transmetuesit.
 - b) *Përdorim i brendshëm (indoor)*: përdorim brenda një godine, duke përfshirë edhe vende të ngjashëm më të si p.sh. një avion, në të cilin ekrani mbrojtës siguron shuarjen e nevojshme për të lejuar përdorim të përbashkët me shërbime të tjera.
 - c) *Sistemet B dhe G*: klasifikim i sistemeve televizive që marrin parasysh karakteristikat e sistemeve televizive që përmban Rekomandimi ITU-R BT.470-6.
 - d) *Frekuencë duplake*: Një çift frekuencash. Përdorimi i tyre për qëllimet për të cilat janë caktuar është i mundur në të njëjtën kohë në transmetim dhe marrje.
 - e) *Fuqia efektive e rrezatuar (e shënuar si ERP) (në një drejtim të dhënë)*: është produkti i fuqisë së furnizuar në antenë dhe amplifikimit të saj referuar një dipoli gjysëm valor në një drejtim të dhënë.
 - f) *Stacion grumbullues (gathering)*: një stacion qëndror në shërbimin fiks që destinohet të përdoret vetëm në marrje.

- g) *Cikli i punës*: raporti, i shprehur në përqindje, i kohës gjatë periudhës prej një ore kur pajisja radio është në transmetim.
 - h) *Frekuencë për përdorim të përbashkët*: një frekuencë e cila, sipas caktimit apo autorizimit individual, është e disponueshme për dy ose më tepër përdorues apo të autorizuar në të njëjtën zonë dhe në të njëjtën kohë (jo të ndarë me njëri tjetrin – no share) pa asnjë garanci mbrojtjeje nga interferencat prej autoritetit të komunikimeve elektronike.
 - i) *Frekuencë për përdorim me ndarje*: një frekuencë që, sipas caktimit apo autorizimit individual, është e disponueshme për dy ose më shumë përdorues apo të autorizuar në të njëjtën zonë por në kohë të ndryshme, me nivel mbrojtjeje nga interferencat të përcaktuar nga autoriteti i komunikimeve elektronike.
 - j) *Frekuencë simpleks*: një frekuencë e vetme. Ajo mund të përdoret për realizimin e vetëm një lidhje (linku) një drejtimshme në një kohë të dhënë (ose transmetim, ose marrje).
 - k) *Master frequency list*: Lista nderkombetare e frekuencave të stacioneve radio e publikuar nga ITU në tabelen e PPF do të shenohet Mfl.
- (2) Terma të tjerë lidhur me administrimin e frekuencave të përdorur në këtë plan interpretohen në përputhje me përcaktimet e dhëna në ligjin nr.9918, ose përcaktime të Radio Rregullores.

Perputhshmeria me legjislacionin e Bashkimit Europian

Neni 9

Ky plan është në përputhje me aktet ligjorë të mëposhtëm të Bashkimit Europian:

1. Nenet 3(2), 4(1), 5(1), 18(1) dhe 18(2) të Direktivës 1999/5/EC mbi pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe njohjen reciproke të konformitetit të tyre;
2. Nenet 5, 6 dhe 11(1)(c) të Direktivës 2002/20/EC mbi autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
3. Nenin 9 të Direktivës 2002/21/EC mbi kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;
4. Vendimin e Komisionit 98/516/EC mbi një Rregullore teknike të përbashkët për stacionet e lëvizshëm toksorë të shërbimit satelitor me ritëm të ulët të dhënash (LMES) që punojnë në brezat e frekuencave 11/12/14 GHz;
5. Vendim i Komisionit 98/533/EC mbi një Rregullore teknike të përbashkët për Stacionet e Lëvizshëm Toksorë (MESs) të Rrjeteve të Komunikimeve Personale me Satelit (S-PCS), përfshi stacionet toksorë portabël, për S-PCN që punojnë në brezat e frekuencave 1,6/2,4 GHz që janë caktuar për Shërbimin e Lëvizshëm Satelitor (MSS).
6. Vendimi i Komisionit 98/542/EC mbi një rregullore teknike të përbashkët për kërkesat ndaj zbatimeve telefonike në komunikimet publike pan-Europiane, dixhitale, celulare, të lëvizshme në tokë, faza e dytë (botimi i dytë);

7. Vendimi i Komisionit 98/543/EC mbi një rregullore teknike të përbashkët për kërkesat ndaj zbatimeve telefonike për stacionet e lëvizshëm që përdoren me fazën II të rrjeteve publike të telekomunikacioneve celulare dixhitale që operojnë në brezin DCS1800 (botimi 2);
8. Vendimi i Komisionit 98/574/EC mbi një rregullore teknike të përbashkët lidhur me kërkesat e përgjithshme për komunikimet pan-Europiane celulare dixhitale publike të lëvizshme në tokë, Faza II (Botimi 2);
9. Vendimi i Komisionit 98/575/EC mbi një rregullore teknike të përbashkët për lidhur me kërkesat e përgjithshme për stacionet e lëvizshëm që përdoren në Fazën II të rrjeteve publike të telekomunikacioneve celulare dixhitale që punojnë në brezin GSM 1800 (Botimi 2);
10. Vendimi i Komisionit 98/578/EC për një rregullore teknike të përbashkët për stacionet toksorë të shërbimit satelitor me ritëm të ulët të dhënash (LMES) që punojnë në brezat e frekuencave 1,5/1,6 GHz;
11. Vendimi i Komisionit 98/734/EC për një rregullore teknike të përbashkët për stacionet toksorë të shërbimit satelitor (LMES) që punojnë në brezat e frekuencave 1,5/1,6 GHz;
12. Vendimi i Komisionit 1999/310/EC për një rregullore teknike të përbashkët për pajisjet DECT që kanë akses në rrjetet dixhitale me shërbime të integruara (ISDN);
13. Vendimi i Komisionit 1999/498/EC për një rregullore teknike të përbashkët për pajisjet dixhitale pa tel të telekomunikacioneve (DECT) që kanë akses në rrjetet dixhitale me shërbime të integruara (ISDN) (Versioni 2);
14. Vendimi i Komisionit 1999/511/EC për një rregullore teknike të përbashkët për kërkesat për stacionet e lëvizshëm me qarqe të kycies së të dhënave me shpejtësi të madhe (HSCSD);
15. Neni 1(1) i Vendimit të Komisionit 2000/299/EC që krijon klasifikimin fillestar të pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve si dhe identifikuesit shoqërues;
16. Vendimi i Komisionit 2001/148/EC për zbatimin e nenit 3(3)(e) të Direktivës 1999/5/EC për sinjalizuesit e orteqeve (beacons);
17. Neni 5 i Vendimit Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi kuadrin rregullator të politikës për spektrin e frekuencave në Bashkimin Europian;
18. Vendimi i Komisionit 2004/71/EC për kërkesat thelbësore ndaj pajisjeve për komunikime radio detare, që destinohen të përdoren në anijet që nuk mbulohen nga marrveshja SOLAS (anije që nuk mbulohen nga Kapitulli IV i SOLAS) dhe marrin pjesë në Sistemin Global të Sigurisë dhe Fatkeqësisë në Det (GMDSS);
19. Vendimi i Komisionit 2004/545/EC për harmonizimin e spektrit radio në diapazonin 79 GHz për përdorim nga pajisjet radar me distancë të shkurtë në automjetet në BE;
20. Vendimi i Komisionit 2005/50/EC mbi harmonizimin e brezit në diapazonin 24 GHz të radio spektrit për përdorim me kufizim kohe nga pajisjet radar me distancë të shkurtë nga automjetet në BE;
21. Vendimi i Komisionit 2005/53/EC për zbatimin e nenit 3(3)(e) të Direktivës 1999/5/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian lidhur me pajisjet radio që destinohen të marrin pjesë në Sistemin e Identifikimit Automatik (AIS);
22. Vendimi i Komisionit 2005/513/EC mbi harmonizimin e përdorimit të radio spektrit në brezin e frekuencave 5 GHz për implementimin e sistemeve të aksesit pa tel (wireless), përfshirë rrjetet lokale (WAS/RLANs);

23. Vendimin e Komisionit 2005/631/EC lidhur me kërkesat thelbësore, duke ju referuar Direktivës 1999/5/EC, për të siguruar akses të sinjalizuesve të sistemit Cospas-Sarsat në shërbimet e emergjencës;
24. Vendimi i Komisionit 2005/928/EC mbi harmonizimin e brezit të frekuencave 169,4-169,8125 MHz në BE.

Neni 10

Informimi dhe publikimi

Ky dokument, PPF, është pjesë e Rregulloreve dhe akteve të tjera të nxjerra nga AKEP dhe publikohet në faqen e internetit të AKEP-it me hytjen në fuqi të tij. Sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë këto PPF dhe këto rregulla. Vendimet dhe Rekomandimet e Komitetit Europian të Radiokomunikacioneve (ERC) dhe Komitetit Europian të Komunikimeve Elektronike (ECC), të cilat përmenden në këtë Rregullorë, mund të merren në faqen e internetit të Zyrës Europiane të Radiokomunikacioneve (ERO), në adresën <http://www.ero.dk>.

Breza të caktuar të PPF që janë në proces studimi ose vlerësimi do të behen publike sapo të jenë të disponueshme.

Ky plan do të përditesohet me:

- 1 - Me caktimet e frekuencave që do të behen nga AKEP
- 2 - Me implementimin e rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve ndërkombetare ku Republika e Shqipërisë aderon
- 3 - Në zbatim të politikave të administrimit dhe zhvillimit të spektrit

Neni 11

Zbatimi i PPF dhe rregullave

Përdorimi i frekuencave dhe sistemeve radio në kundërshtim me PPF dhe këto rregulla përbën kundërvajtje administrative dhe zbatohen nën 137 e në vijim të ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Pas administrimit të aplikimit për marrjen në përdorim të frekuencave/frekuencave nga sipërmarrësit, llogaritja për shkak të interferencave dhe koordinimit, do të behen nga AKEP.

Neni 12

Hyrja në fuqi

PPF dhe këto rregulla hyjnë në fuqi me miratimin e tij me vendimin e Këshillit Drejtues Nr.1490, datë 17.01.2011, dhe mbetet në fuqi deri në daljen e një PPF tjetër dhe rregullash të tjera.